



REPUBLIKA E SHQIPËRIË

**BASHKIA MALIQ**  
**KËSHILLI BASHKISË**

Datë 31.08.2023

Prot.5 (pesë)

Protokoll nr. 5

I mbajtur sot më datë 31.08.2023, në mbledhjen e radhës së Këshillit të Bashkisë Maliq, në sallën e mbledhjeve të këshillit të bashkisë, ora 10:00.

Rend Dite:


1. Hapja e mbledhjes (korumi, miratimi i rendit të ditës, vendimet e mbledhjes së kaluar);
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së datës 21.07.2023;
3. P-V "Për miratimin e Ndihmës Ekonomike deri në masën 6% të fondit për muajin korrik 2023";
4. P-V "Për Miratimin e Rregullores, ngritjen dhe funksionimin e Komisionit të Strehimit në Bashkinë Maliq";
5. P-V "Për prononcimin në lidhje me përfshirjen e objektit me nr.pasurie 282/90, ZK 3005, me emërtimin, "Shkolla e vjetër" në procedurën e privatizimit, të ndodhur në fshatin Pocestë, Njësia Administrative Libonik, Bashkia Maliq";
6. P-V "Për ngritjen dhe miratimin e Komisioneve të përhershme të Këshillit të Bashkisë Maliq";
7. Diskutime mbi fillimin e procedurave për zgjedhjen e Strukturave Komunitare në Fshat.
8. Informacion i kërkuar nga grupi i Këshilltarve Opozitarë në mbledhjen e datës 21.07.2023.
9. Ndryshimet klimatike, ndërmarrja e masave efektive ndaj tyre.
10. Diskutime të tjera.

**Këshilltarë të pranishëm në sallë:**

Ornildi Demollari; Rudina Bregu; Xhuana Hoxhallari; Floreta Zaçe; Ildir Limllari; Petrit Kupe; Fevri Sherifi; Dritan Çami; Ronaldo Skënderi; Yllson Ibrahimllari; Nersida Shindo; Server Xhuti; Faslli Zholi; Eglantina Balli; Andonaq Risto; Aleksandra Spaho; Albina Xhejo; Dalina Krekas; Aramando Dautllari; Almir Elezi; 20 (njëzetë) këshilltarë.

**Të pranishëm nga Administrata:**

Kryetari i Bashkisë: z.Gëzim Topçiu; Përgjegjës i Sektorit: Ujtje-Kullim Astrit Zholi; Përgjegjës i Sektorit të Bujëqsisë: z.Arben Dulellari; Përgjegjës i Sektorit Pyje-Kullota: z.Klaresen Brako





REPUBLIKA E SHQIPËRISË



Përgjegjës i Zyrës të Strehimit: z.Ledion Mullalli; Specialiste e Sektorit të Shërbimit Social Agathi Ngjela.

**Ornildi Demollari:** Mirëdita të gjithëve! Bazuar në ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, kemi thirrur këtë mbledhje të radhës së Këshillit të Bashkisë Maliq, me rend dite prej 10 pikash, besoj se me rendin e ditës dhe materialet jeni njohur më parë, kështu bëjmë një verifikim të korumit, kemi 20 Këshilltarë në sallë, korumi realizohet dhe mund të fillojmë me mbledhjen e Këshillit. Mbledhjen e deklaroj të hapur dhe ju ftoj të miratojmë rendin e ditës.

Kush është dakord?

Kundra? Nuk ka.

Abstenim? Nuk ka.

Miratohet me 20 vota pro. Faleminderit!

Më lejoni t’ju njoh me vendimet e mbledhjes së datës 21.07.2023, janë gjithësej 9 vendime, 4 janë me karakter normativ që dërgohen në Prefekturë dhe miratohen nga Prefekti i Qarkut dhe 5 me karakter kolektiv ose individual.

**-Vendim nr.83, datë 21.07.2023**

“Mbi miratimin e projektit “Shërbime mbështetëse dhe fuqizuese në familje për të moshuarit me aftësi të kufizuar” me financim të përbashkët nga Fondi Social i Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Bashkisë Maliq”;

**2-Vendim nr.85, datë 21.07.2023**

“Për miratimin e kërkesës së Bashkisë Maliq, së bashku me dokumentacionin tekniko-ligjor për akordimin e ndihmës financiare për familjen e znj.Lirika Demir banesa e të cilës është dëmtuar si rezultat i rënies së zjarrit.

**3-Vendim nr.86, datë 21.07.2023**

“Për miratimin e Planit Vendor të Emergjencave Civile në Bashkinë Maliq”;

**4-Vendim nr.87, datë 21.07.2023**

“Për miratimin e taveve përfundimtare të shpenzimeve të programit buxhetor afat-mesëm 2024-2026 në nivel programi”;

Gjithësej 4 (katër) vendime

Ju vemë në djeni se në mbledhjen e datës 21.07.2023 të këshillit të Bashkisë Maliq u miratuan dhe 5 (pesë) vendime me karakter kolektiv ose individual, përkatësisht:

**1-Vendim nr.79, datë 21.07.2023**

“Për miratimin e rendit të ditës të mbledhjes së datës 21.07.2023”;

**2-Vendim nr.80, datë 21.07.2023**

“Për miratimi i procesverbalit të mbledhjes së datës 30.06.2022”;

**3-Vendim nr.81, datë 21.07.2023**

“Për miratimin e Ndihmës Ekonomike deri në masën 6% të fondit për muajin qershor 2023”;

**4-Vendim nr.82, datë 21.07.2023**

“Për dhënien e Ndihmës Financiare për shërbimin mjeksor për fëmijët në nevojë në kuadër të bashkëfinancimit të projektit për Qendrën Komunitare Maliq, në bashkëpunim me BULGARIAN DEVELOPMENT AID”;



REPUBLIKA E SHQIPËRIË



### 5-Vendim nr.84, datë 21.07.2023

“Për dhënien e bursave për arsimin e mesëm të përgjithshëm viti shkollor 2022-2023 nga fondet e Bashkisë Maliq”; Këto ishin 9 vendimet.Ju ftoj të miratojmë protokollin e mbledhjes së kaluar.

Kush është dakord me protokollin e mbledhjes?

Kundra? Nuk ka.

Abstenim? Nuk ka.

Miratohet me 20 vota pro protokollin. Faleminderit!Kalojmë te pika 3 e rendit të ditës, P-V “Për miratimin e Ndhmës Ekonomike deri në masën 6% të fondit për muajin korrik 2023”;

Ka ndonjë pyetje?

**Aleksandra Spaho:**Përshëndetje të gjithëve!Në mbledhjen e kaluar, kam bërë një propozim për personat që ndodhen jashtë Shqipërie siGreqi për një muaj dhe nuk përfitojnë dot ndihmën ekonomike sepse nuk paraqiten dot te zyra dhe penalizohen për 6 muaj, personat janë kthyer nga emigrimi, ne si bashki me fondin 6% ose 3% ti verifikojmë familjet që kanë nevojë ti ndihmojmë deri sa të rifuten në skemë, sepse mua më duket jo logjike që një Këshilltar pahuhet edhe pse nuk është prezent në mbledhjen e Këshillit dhe i kalon rroga, qytetarët penalizohen për 6 muaj.Nëse do kemi mundësi ti diskutojmë këto familje.Ju faleminderit!

**Ornildi Demollari:**Faleminderit! Ka diçka tjetër për këtë pikë? Kryetar!

**Kryetari i Bashkisë: z.Gëzim Topçiu:**Ligji e përjashton këtë dhe fondi 6%, e vetmja mundësi mund të jetë që ne mund ti trajtojmë me fonde që buxheti i bashkisë ka parashikuar për familje në nevojë dhe kjo ndoshta duhet të rishikohet nga Sektori i Shërbimit Social nëse ka familje në gjendje të vështirë dhe le të sjellë propozime rast pas rasti ti trajtojmë nga fondi social që ne kemi parashikuar në buxhet, të shihet si rast të rakordohemi me punnjëset sociale në Nj.A që kemi për të bërë një listim të familjeve që janë penalizuar për 6 muaj dhe nëse ka familje vërtet , familje të vështirë ekonomike të shihet mundësia për tu trajtuar me këtë fond, me fondin 6% ne nuk mund ti trajtojmë dot sepse dhe ata trajtohen sipas ligjit për Shërbimin Social.

**Ornildi Demollari:**Faleminderit! Ka diçka tjetër? E kalojmë në votim?

Kush është dakord ?

**Kryetari i Bashkisë: z.Gëzim Topçiu:**Shqetësimi që u ngrit duhet parë nga Sektori për mbledhjen e radhës që mos mbetet evazive, të shihen familjet.

**Yllson Ibrahimllari:**Të jemi racional, ne kemi ngritur një grup që e kemi praqitur dhe të drejtën e fjalës për Këshilltarët e kenë ju, ndërsa kur e kemi në emër të grupit ne përcaktojmë një radhë, në mbledhjen e para kemi rënë dakord që lista 6% të bëheshe transparente në çdo NJ.A, çfarë masa kemi marrë?Për gjendjen ekonomike të familjeve, të listohen këtu, pastaj pjesa tjetër është një debat që na konsumon kohë në çdo mbledhje.Do bjemë dakord që këto lista të shpallen në çdo NJ.A pastaj vetë komuniteti do bjerë dakord me përfituesit?

**Kryetari i Bashkisë: z.Gëzim Topçiu:**Lista me përfituesit e fondit 6% dhe skema e ndihmës ekonomike afishohen se e ke kemi detyrim ligjor në çdo Nj.A dhe bashki që njerzit të njihen dhe



REPUBLIKA E SHQIPËRISË



pastaj ne marrim vlersime për vendimarrjen në fjalë, ndaj dhe unë besoj që nuk ka ngërç për këtë punë. Nuk duhet të hyjmë në emra konkretë, ne duhet të kërkojmë të zbatohet ligjo nga strukturat tona dhe të gjejmë mundësitë ligjore të jemi sa më afër qytetarve që juy takon kjo ndihmë ekonomike. Shumë faleminderit!

**Ornildi Demollari:**Faleminderit! Ka diçka tjetër? E kalojmë në votim?

Kush është dakord ?

Kundra? Nuk ka.

Abstenim? Nuk ka.

Miratohet me 20 vota pro. Faleminderit! Kalojmë te pika 4 e rendit të ditës, P-V “Për Miratimin e Rregullores, ngritjen dhe funksionimin e Komisionit të Strehimit në Bashkinë Maliq”;

**Ornildi Demollari:**Ka ndonjë pyetje? Nga këshilltarët e opozitës ka diçka?

**Yllson Ibrahimllari:**Pse nuk kanë të drejtë të flasin këshilltarët e opozitës?

**Ornildi Demollari:**Kërkoj fjalën Këshilltarja juaj, ndaj morra shkas. Ka ndonjë?

**Kryetari i Bashkisë: z.Gëzim Topçiu:**Kjo është një procedurë standarte dhe unë mendoj që kjo është një rregullore e rëndësishme dhe për efekt se dhe bashkia jonë ka një zyrë strehimi dhe është shumë e rëndësishme të jemi sa më afër qytetarve që kanë nevojë për strehim dhe kjo rregullore si detyrim ligjor duhet të miratohet nga ana e Këshillit të bashkisë si nga pjesa ligjore dhe përbërja. I vetmi moment këshillit është që në këtë komision duhet të jetë një përfqesues i Këshillit të bashkisë i cili duhet të plotësohet nga ana juaj, i cili mund të plotësohet në rang emri apo pozicioni, përgjegjësi i zyrës mund të japë dhe ndonjë sqarim nëse kenë pyetje, por unë e quaj një procedurë standarte, çdo gjë jo vetëm këtu por dhe në komisionin e strehimit është e hapur sipas akteve ligjore, ne nuk kemi vendimarrje të shumta nga komisioni i strehimit, i vetmi moment ka qenë ndarja e pallatit që nuk kemi patur probleme, por shpresojmë të kemi ndërtime të tjera, apo vendimarrje të tjera, si kredi me interesa të vogla, apo dhe shtëpi që ju paguajmë qiranë familjeve në nevojë, për të cilat janë punë e zyrës dhe i vijnë Këshillit për vendimarrje rast pas rasti i kalon për efekt të ekzekutivit. Rregullorja ashtu si e ka emrin rregullon gjithë këtë marrdhënie midis organit ekzekutiv dhe këshillit të bashkisë për çdo vendimarrje që do merret rast pas rasti.

**Ornildi Demollari:**Faleminderit! Ka diçka tjetër? Nga të dy grupet?

**Yllson Ibrahimllari:**Kemi kritere të përcaktuara dhe sa janë inxhinieret e ndërtimit në Këshill për pasur një CV profesionale të përfaqësuesit që do propozojë Këshilli? Përfaqësuesi të jetë i një profesioni që i takon, si psh urbanist, kemi një inxhinier me profesion në këshill me sa dëgjova herën e kaluar.


**Ornildi Demollari:**Ju propozin Inxhinierin?

**Yllson Ibrahimllari:** Unë nuk propozoj askënd, por propozimet që na takojnë me ligj të kemi një CV që duhet të përmbushë kandidati.

**Petrit Kupe:**Unë mendoj që, në këtë vlersim nuk duhet para ana profesionale më shumë se çka ai përfaqëson në komunitet, atje nuk ndërtohet pallat që të kemi inxhinier por me duhet të mbrojmë interesa e komunitet dhe duhet një këshilltar i përgjegjshëm, këtë kisha.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË



**Ornildi Demollari:**Faleminderit! Diskutimi është të pika e fundit te emri që do përfaqësojë këshilli, prisja debat rreth materialit, mund të bëni propozime të dy grupet. Personalisht dhe për mua që propozime jonë duhet të jetë që përfaqësojë me fushën e ndërtimit.

**Ornildi Demollari:**Për rregulloren ke diçka Ledion?

**Përgjegjës i Zyrës të Strehimit z.Ledion Mullalli:**Këto janë procedura ligjore, këshill ka një përfaqësues te ky komision.

**Ornildi Demollari:**Në rregull e kuptova, duhet ta përzgjedhim sot anëtrin e Këshillit?

**Përgjegjës i Zyrës të Strehimit z.Ledion Mullalli:**Po.

**Yllson Ibrahimllari:**Sot një pikë në rendin e ditës, kemi komisionet, ta miratojmë në parim dhe me zgjedhjen e komisioneve të përhershme, komisioni i strehimit ta zgjedhë përfaqësuesin e tij dhe të na i propozojë në mbledhjen tjetër.

**Kryetari i Bashkisë: z.Gëzim Topçiu:**Unë do isha që përfaqësuesi i Këshillit në Komisionin të jetë kryesuesi i Komisionit të Strehimit, mos kemi emra sepse rregullorja ndryshon herë pas here, ju do votini komisionet sot dhe besoj se di jetë në kër linjë me profesion dhe të votohet Kryetari i Komisionit të Zhvillimit Hapsinor dhe Strehimit.

**Ornildi Demollari:**Dakord? Ta votojmë pa emër?

**Kryetari i Bashkisë: z.Gëzim Topçiu:**Dhe përfaqësuesit e admisnitratës janë pa emër në rregullore.

**Ornildi Demollari:**E kalojmë në votim, rregulloren bashkë me antarin e këshillit i cili do jetë përfaqësues në këtë komision, pra i Komisionit të Zhvillimit Hapsinor dhe Strehimit do jetë përfaqësues ai atij komisioni. E kalojmë në votim kështu?

**Aleksandra Spaho:**Unë do votoj kundra për këtë se jam njohur me vonesë.

Kush është dakord ?

Kundra? 1 votë, Aleksandra Spaho

Abstenim? Nuk ka.

Miratohet me 19 vota pro. Faleminderit!Kalojmë te pika tejtër e rendit të ditës, P-V "Për prononcimin në lidhje me përfshirjen e objektit me nr.pasurie 282/90, ZK 3005, me emërtimin, "Shkolla e vjetër" në procedurën e privatizimit, të ndodhur në fshatin Pocestë, Njësia Administrative Libonik, Bashkia Maliq";

**Ornildi Demollari:**Ka ndonjë pyetje për këtë, ndonjë paqartësi?

**Petrit Kupe:**Jam i njohur me problemin, për arsye sepse kjo shkolë nuk është në funksion që nga viti 2014 dhe nuk e di pse është zgjatur kaq shumë për tu ndjekur procedura, kjo procedurë për tu ndjekur i takon bashkisë dhe NJ.A dhe Ministria e Financave do bëjë privatizimin, pak me vonesë por jam dakord me propozimin.

**Ornildi Demollari:**Faleminderit! Ka ndonjë pyetje tjetër? Kryetar?

**Kryetari i Bashkisë: z.Gëzim Topçiu:**Nga ajo që shikoj unë është një procedurë standarte ligjore, Ministria e Financave ka shprehur dakortësinë për privatizimin, por që të ndodhë ky privatizim, që të ndodhë ky privatizim që e bëjnë ata jo ne, duhet të shprehemi në parim që jemi dakord dhe nuk na shërben kjo godinë për shkolle, apo qendër shëndetësore, këto godina janë bërë të reja. Ajo është një godinë e amortizuar, më mirë ta mirëbajë dikush se të shkatrohet plotësisht, do isha në prim që Këshilli të shpreheshë pozitivisht për këtë P-V.

**Ornildi Demollari:**Faleminderit!Kemi një znj. Që ka erdhur për këtë pikë.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Jam një banore e fshatit Pocestë dhe kam bërë një kërkesë për blerjen e shkollës së vjetër e cila është ngjitur me banesën time, me një mur dhe çati të përbashkët, po e mirëmbaj vetë se ishte e shkatruar fare me një investim për mbulesë, për të mbrojtur shtëpinë time. Objekti ishte shumë i shkatruar unë kam bërë investime. Dua ta ble për të mbrojtur shtëpinë time.

**Ornildi Demollari:** Faleminderit! Ka diçka tjetër?

**Aleksandra Spaho:** Ne kujt do ja japim Ministrisë apo zonjës?

**Kryetari i Bashkisë: z.Gëzim Topçiu:** Ministria kryen procedurat, ne vetëm shprehim dakord, procedurat i ndjek Minsitria, jo vetëm për këtë pronë, por për të gjitha që janë në teritorrin e Bashkisë.

**Ornildi Demollari:** E kalojmë në votim?

Kush është dakord ?

Kundra? Nuk ka.

Abstenim? Nuk ka.

Miratohet me 20 vota pro. Faleminderit! Kalojmë te pika 6 e rendit të ditës, P-V "Për ngritjen dhe miratimin e Komisioneve të përhershme të Këshillit të Bashkisë Maliq"; Në një mbledhje të kaluar ka patur një kërkesë të Këshillatrive të opozitës të cilët kërkonin një përfaqësim në totalin e këtyre komisioneve, besoj kryetarët e grupeve së bashku me Sekretarin janë ulur bashkë për të realizuar kërkesën për opozitës. Kryetarja e grupit të PS ka një material për të lexuar ta dëgjojmë.

**Rudina Bregu:** Përsëritje të gjithëve! Në vijim të asaj që tha Kryetari i Këshillit ne e kemi diskutuar dhe në një mbledhje më parë, për 14 Komisionet e përhershme, unë do ju lexoj përbërjen për të 14 Komisionet të Këshillit. Nëse dikush ka propozim tjetër ne mund ti ndryshojmë Komisionet.

**Kryetari i Bashkisë: z.Gëzim Topçiu:** Kam një sygjërim ti kalojmë Komisionet një dhe nga një, këshilltarët janë njohur me emrat më parë, por duke u lexuar emrat te çdo komision dh të miratohet.

**Rudina Bregu:** Kemi diskutuar dhe jemi munduar ti përfarojmë sipas profileve.

**1-Komisioni Rregullorëve, Çështjeve Juridike, Qeverisjes së Mirë, Administratës, Zgjedhjeve, Strukturave Komunitare.**

1-Xhuana Hoxhallari

2-Petrit Kupe

3-Pranvera Begolli

4-Nersida Shindo

5-Eglantina Balli

**Yllson Ibrahimllari:** Të shtohet dhe profili i antëarve. E kalojmë në votim?

Kush është dakord ?

Kundra? Nuk ka.

Abstenim? Nuk ka.

Miratohet me 20 vota pro. Faleminderit!

**2-Komisioni i Etikës, Standarteve dhe Apelineve.**

1-Gentiana Drabo



REPUBLIKA E SHQIPËRISË



- 2-Klea Baçi
- 3-Ronaldo Skënderi
- 4-Server Xhuti
- 5-Lulëzim Hoxhaj

Kush është dakord ?

Kundra? Nuk ka.

Abstenim? Nuk ka.

Miratohet me 20 vota pro. Faleminderit!

**3-Komisioni i Financave, Buxhetit, Pasurive Bashkiake, dhe Planifikimit të Zhvillimit Strategjiktë Bashkisë, Mbikqyrjes Financiare.**

- 1-Rudina Bregu
- 2-Pranvera Begolli
- 3-Petrit Kupe
- 4-Aleksandra Spaho
- 5-Andonaq Risto

Kush është dakord ?

Kundra? Nuk ka.

Abstenim? Nuk ka.

Miratohet me 20 vota pro. Faleminderit!

**Yllson Ibrahimllari:** Kam kërkuar Sekretarit të Këshillit të bëhen publike në faqen e Këshillit të gjitha CV e Këshilltarve.

**Ornildi Demollari:** Shumë dakord në rregull!

**4-Komisioni i Shërbimeve Publike, Transportit, Lëvizshmërisë Mjedisore, Parqeve dhe Rekreacionit, Parkingjeve.**

- 1-Idlir Limllari
- 2-Ilia Xhuti

3-Rovena Terolli

4-Eglantina Balli

5-Faslli Zholi

Kush është dakord ?

Kundra? Nuk ka.


Abstenim? Nuk ka.

Miratohet me 20 vota pro. Faleminderit!

**5-Komisioni i Ekonomisë Vendore, Turizimit dhe Zhvillimit Rural.**

- 1-Ornildi Demollari
- 2- Petrit Kupe
- 3-Marianthi Avrami
- 4-Eglantina Balli
- 5-Lulëzim Hoxhaj

**6- Komisioni i Zhvillimit Hapësinor, Infrastrukturës dhe Strehimit.**



1. Ildir Limllari
2. Eriseld Jonusllari
3. Pranvera Begolli
4. Almir Elezi
5. Faslli Zholi

Kush është dakord ?

Kundra? Nuk ka.

Abstenim? Nuk ka.

Miratohet me 20 vota pro. Faleminderit!

**7-Komisioni i Sigurisë Publike, Emergjencave Civile dhe Rehabilitimit.**

1. Dritan Çami
2. Ilia Xhuti
3. Floreta Zaçe
4. Eglantina Balli
5. Yllson Ibrahimllari

Kush është dakord ?

Kundra? Nuk ka.

Abstenim? Nuk ka.

Miratohet me 20 vota pro. Faleminderit!

**8- Komisioni i Mirëqënies Sociale, Rinisë, Barazisë Gjinore, Mosdiskriminimit, Drejtave të Njeriut.**

1. Gentiana Drabo
2. Armando Dautllari
3. Plator Çollaku
4. Nersida Shindo
5. Aleksandra Spaho

Kush është dakord ?

Kundra? Nuk ka.

Abstenim? Nuk ka.

Miratohet me 20 vota pro. Faleminderit!

**9- Komisioni i Shëndetësisë, Veterinarisë, Mjedisit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit.**

1. Yllson Ibrahimllari
2. Dritan Çami
3. Enida Avdolli
4. Klea Baçi
5. Eglantina Balli

Kush është dakord ?

Kundra? Nuk ka.

Abstenim? Nuk ka.

Miratohet me 20 vota pro. Faleminderit!





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**10-Komisioni i Bujqësisë, Pyjeve, Menaxhimit të ujrave, Mbrojtjes së Mjedit dhe Biodiversitetit.**

- 1.Fevri Sherifi
- 2.Marianthi Avrami
- 3.Rovena Terolli
4. Albina Xhejo
5. Faslli Zholi

Kush është dakord ?

Kundra? Nuk ka.

Abstenim? Nuk ka.

Miratohet me 20 vota pro. Faleminderit!

**11- Komisioni i Arsimit, Sporteve dhe Çlodhjes.**

- 1.Gentina Drabo
- 2.Daniela Ibrahim
3. Albina Xhejo
4. Lulëzim Hoxhaj
5. Faslli Zholi

Kush është dakord ?

Kundra? Nuk ka.

Abstenim? Nuk ka.

Miratohet me 20 vota pro. Faleminderit!

**12-Komisioni i Kulturës, Trashëgimisë Kulturore, Dhënies së Titujve, Emërtimeve.**

- 1.Daniela Ibarahim
- 2.Almir Elezi
3. Floreta Zaçe
4. Faslli Zholi
5. Server Xhuti

Kush është dakord ?

Kundra? Nuk ka.

Abstenim? Nuk ka.

Miratohet me 20 vota pro. Faleminderit!

**13-Komisioni i Qeverisë Elektronike dhe Teknologjisë së Informacionit.**

- 1.Armando Dautllari
- 2.Erisled Jonusllari
- 3.Gentiana Drabo
4. Eglantina Balli
5. Dalina Krekas

Kush është dakord ?



REPUBLIKA E SHQIPËRISË



Kundra? Nuk ka.  
Abstenim? Nuk ka.  
Miratohet me 20 vota pro. Faleminderit!

#### 14- Komisioni për Marrëdhënjet me jashtë dhe Integrimin Europian.

1. Plator Çollaku
2. Xhuana Hoxhallari
3. Rudina Bregu
4. Aleksandra Spaho
5. Lulëzim Hoxhaj

**Ornildi Demollari:** Do bëhet ndryshimi i emrit të znj. Egalantina Balli me znj. Aleksdandra Spaho.

**Yllson Ibrahimllari:** Te ky Komision të ketë në përbërje anglisht folës me certifikatë B2, për patur lehtësi në takimit e Kryetarit me delegacionet e huaja. Në mbledhjen tjetër do propozoj 5 binjakëzime të Bashkisë Maliq.

**Ornildi Demollari:** Shumë faleminderit! Ke të drejtë.

Kush është dakord ?

Kundra? Nuk ka.

Abstenim? Nuk ka.

Miratohet me 20 vota pro. Faleminderit! Me ndryshimin.

**Ornildi Demollari:** Miratohet me 20 vota pro P-V. Kalojmë te pika 7 e rendit të ditës, Diskutime mbi fillimin e procedurave për zgjedhjen e Strukturave Komunitare në Fshat. Kryetarët e Komisioneve zgjidhen nga vetë anëtarët e Komisioneve në mbledhjen e tyre të parë.

**Yllson Ibrahimllari:** Nëse duam të jemi ata që duam të përfaqësojmë komunitet, të bëjmë një marrëveshje dhe mos përdorim forcën e kartonit. Këto komisione mund të drejtohen nga ju.

**Ornildi Demollari:** Kemi marrë parysh që disa komisione të drejtohen dhe nga ju.

**Yllson Ibrahimllari:** Ne kërkojmë nga ju disa mekanizma kontrolluese që i lejon ligji, duke mos marrë kompetencat Kryetarit, nëse ne do na japësh komisionin e titujve kemi kryetar Server Xhutin, nëse ju keni Financat ne do mbajmë Planifikimin, të kemi disa mekanizma kontrollues, ti kemi parysh këto.

**Ornildi Demollari:** Faleminderit! Të kuptova.

**Kryetari i Bashkisë: z. Gëzim Topçiu:** Patjetër që unë do sygjeroja që Këshilli të ketë një bashkëpunim në të gjitha aspektet, por kjo nuk do të thotë që për hir të këtij bashkëpunim ta rëzojmë atë çka vendosur votuesi, votuesi ka dhënë një shumicë. Unë ju sygjeroj dhe Kryetarve të grupeve të bëjnë propozime konkrete nga të dy palët dhe vetë komisionet do zgjedhin. Atje bëhet një marrëveshje midis palve që të ketë një gjithë përfshirje.


**Petrit Kupe:** Opozitës minimalisht i takojnë 30% të Komisioneve për drejtim, ti bëjnë konkretisht propozimet që kërkojnë.

**Yllson Ibrahimllari:** I kemi dorzuar 5 ose 4 emrat që kërkojmë për drejtimin e Komisioneve.

**Kryetari i Bashkisë: z. Gëzim Topçiu:** Opozita kërkon të marrë në parim sa më shumë Komisione që ajo mendon se mund të ketë për një kontroll dhe është e drejta e tyre, ju sygjeroj se dhe jo atë kërkojnë ata do jetë vendimarrja jonë, duhet të jemi realist për të bërë sa më shumë



REPUBLIKA E SHQIPËRISË



punë në shërbim të komunitetit dhe kjo të jetë ligjërish. Mbeldhjet e para të Komisioneve duhet të jenë në këtë prizëm.

**Rudina Bregu:** Ne jemi munduar së bashku me Sekretarin e Këshilit të bëjmë një ndarje të Komisioneve sipas profileve dhe të atyre që medojmë ti përkasin opozitës.

**Ornildi Demollari:** Faleminderit! Në rregull, Opozita kërkon këto Komisione:

1-Komisioni i Mirëqënies Sociale, Rinisë, Barazisë Gjinore, Mosdiskriminimit, Drejtave të Njeriut. Të drejtohet nga Neresida Shindo.

2-Komisioni i Bujqësisë, Pyjeve, Menaxhimit të ujrave, Mbrojtjes së Mjedit dhe Biodiversitetit. Të drejtohet nga Faslli Zholi.

3-Komisioni i Arsimit, Sporteve dhe Çlodhjes.

Të miratohet nga Lulëzim Hoxhaj. Kryesimi të diskutohet më vonë.

Kryetarët e Komisioneve do të zgjidhen në mbledhjen e parë të Komisioneve. Kalojmë te pika tjetër e rendit të ditës, Diskutime mbi fillimin e procedurave për zgjedhjen e Strukturave Komunitare në Fshat.

**Petrit Kupe:** Të konsituohen sa më shpjet komisionet, ne kemi në mbledhje mungesa jo më në Komisione.

**Ornildi Demollari:** Shumë faleminderit! Ke të drejtë.

Kush është dakord?

Kundra? Nuk ka.

Abstënim? Nuk ka.

Miratohet me 20 vota pro. Faleminderit! Me ndryshimin.

**Ornildi Demollari:** Miratohet me 20 vota pro P-V. Duke dhënë dakortësinë për Komisionet që do drejtojnë opozita.

**Kryetari i Bashkisë: z.Gëzim Topçiu:** Këshilli miraton Komisionet jo kryesuesit e tij, këshilli mund të bëjë vetë lëvizje sipas propozimeve.

**Ornildi Demollari:** Brenda mbledhjeve të Komisioneve mund të zgjidhni kë Komisioni do drejtojnë opozita. E mbyllim këtë çështje. Kalojmë te pika 7 e rendit të ditës, Diskutime mbi fillimin e procedurave për zgjedhjen e Strukturave Komunitare në Fshat. Do diskutojmë për zgjedhjen e Kryetarve të fshatrave dhe Kryesisë.

**Petrit Kupe:** Nesë keni ndonjë eksperiencë të më parshme na i thoni për ne që nuk kemi qenë, si organizohet.

**Ornildi Demollari:** Kjo është kompetencë e Këshillit, mbështur në ligjin 139/2015, Këshilli i Bashkisë në një hark kohor, nga data e zgjedhjeve, organizon procesin e zgjedhjes së Kryetarve të fshatrave, në rast se skadon ky afat apo dalin probleme të tjera, atëherë Kryetari i bashkisë i emëron përkohësisht.

**Kryetari i Bashkisë: z.Gëzim Topçiu:** Këshilli i bashkisë është i vonuar në këtë pikë, duhet të kishte filluar procedurën, ka një praktikë nga zgjedhjet e para, e cila përcakton dhe mënyrën si zgjidhen, këshilli përcakton disa modalitete për zgjedhjen e Strukturave Komunitare në fshat, me lagje apo në bazë fshati dhe ndarjen Këshilltave që mbikqyrin procesin. Këshilli nuk ka ndonjë proces vendimarrës, por mbikqyrin dhe mbajnë një proces verbal për çdo fshat. Duhet bërë një P-V duke përcaktuar ndarjen dhe mënyrën e zgjedhjeve, duke ju dhënë të dy opsionet, zgjedhjet për Strukturave Komunitare i organizon fshati, ajo çka duhet të ndodhë është që strukturat e



REPUBLIKA E SHQIPËRISE



forcave politike të bëjnë propozime konkrete kush do drejtojë lagjen apo fshatin dhe Sekretari i Këshillit të Bashkisë ndjek gjithë procedurën, për ti pajisur me materiale të nevojshme, fletë votimi, kuti votimi etj. Bashki të tjera i kanë filluar dhe një pjesë i kanë mbyllur. Kjo procedurë duhet të mbyllet brenda muajit Shtator.

**Ornildi Demollari:** Faleminderit Kryetar!

**Aleksandra Spaho:** Në lidhje me këtë që thoni ju me lagje, fshati Pojan ka 5 lagje dhe këta kanë nga një përfaqësues dhe këta 5 zgjedhin Kryetarin e fshatit ose drejtpërdrejtë nga i gjithë fshati.

**Ornildi Demollari:** Ose i gjithë fshati ose me lagje, duhet të përcaktojmë bashkarisht disa data.  
**Kryetari i Bashkisë: z. Gëzim Topçiu:** Votimi mund të bëhet në një ditë i gjith ose në dy ditë, nuk mund të shkojë Këshilltari i NJ.A në një NJ.A tjetër. Mendoj që vetë grupet të ndajnë përfaqësuesit e tyre sipas zonave. Atje ku nuk ka përfaqësuese grupi çon dikë tjetër. Ne duhet të preçizojmë një ndarje me ditë ashtu si me Komisionet.

**Ornildi Demollari:** Duhet të bëjmë dakord për datat 9-10 shtator, nuk kemi pse shkojmë më tej. Kryetarët e grupeve të Këshillit të bëjnë ndarjen për Këshilltarët që do monitorojnë procesin për çdo NJ.A.

**Kryetari i Bashkisë: z. Gëzim Topçiu:** Kryetar që të përcaktojmë qartë, Këshilltarët nuk kanë asnjë kompetencë vendimarrse atje ku shkojnë, banorët e ngrenë vetë Komisionin dhe zgjedhin mënyrën se si do e bëjnë votimin. Këshilltarët ndjekin procesin që mos ketë abuzime dhe shkelje, kur vinë në Këshill të dy grupet sjellin një informacion se se ka ecur situata dhe ku pati probleme dhe ku jo, të gjëjmë zgjidhjen pastaj si do veprojmë.

**Ornildi Demollari:** Sekretari i Këshillit duhet ti asistojë me bazën e logjistikës.

**Faslli Zholi:** Ky është një proces shumë i rëndësishëm, të vendosim disa kritere që të zgjidhen njerzit e duhur, se shikoj në disa fshatra që nga Kryetar fshati që nuk janë efektivë. Këtë proces duhet ta vlersojmë më shumë pozitivitetet të zgjidhim njerzit e duhur. Faleminderit!

**Petrit Kupe:** Mendoj që datat 9-10 Shtator nuk janë të mjaftueshme sepse me këto zgjedhje ka raste që vonohen më shumë, të lemë dhe data të tjera, duhet një përartije midis dy grupeve për të nxjerë emrat e kandidatve.

**Ornildi Demollari:** Ligji ka përcaktuar dhe varjantin B, kur dështon kjo, i emëron Kryetari i Bashkisë.

**Kryetari i Bashkisë: z. Gëzim Topçiu:** Mendoj që po të fillojë puna menjëherë mund të kapet, periudha e ngushtë është, grupet përaktose duhet të përcaktojnë antëtarët e Këshillit që do ndjekin procesin për çdo NJ.A dhe duhet të propozojnë në strukturat e veta emrat të cilët do garojnë, por atje mund të konkurojë dhe dikush që është i pavarur e ka këtë të drejtë. Gupi i majtë garon me këtë listë dhe grupi i dhjathtë me këtë listë ose mund të mos ketë emër fare. Dy Kryetarët e grupeve duhet të ndajnë sot Këshilltarët sipas zonave dhe kush do merret konkretisht me propozimet duke lenë dhe data të caktuara, pastaj si do e zgjedhë fshati, unë jam dakord me z. Faslli sepse e ndjej dhe unë, por fshati e di kë do zgjedhi.

**Yllson Ibrahimllari:** Në vijim të fjalës të Kryetarit mendoj se data 9-10 Shtator është e parakoshme, na duhet një kohë fizike të marrim nga oragnet e drejtësisë që nuk ka proces gjyqësor a i që do kandidojë. Ligji e përcakton vetë, ne duhet të bëjmë seleksionin kush ka probleme me dëshminë e penalitetit.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**Ornildi Demollari:**Ne kemi për detyrë ta fillojmë procesin dhe ta mbikqyrim, nuk kemi të drejtë të shohim dëshminë e penalitetit të asnjërit prej tyre, hapësira ligjore nuk na i lejon.

**Kryetari i Bashkisë: z.Gëzim Topçiu:**Të lemë katër data 9-10 dhe 16-17 shtator.Bëni ndarjen dhe bini bashkarisht dakord për të filluar procesi.Katër data janë të mjetueshme.

**Ornildi Demollari:**Për ta preçisuar kemi katër data 9-10 dhe 16-17 shtator.Kryetarët e grupeve duhet të bjenë dakord për Këshilltarët që do monitrojnë procesin, Sekretari i Këshillit duhet të fillojë menjëherë procesin.

**Kryetari i Bashkisë: z.Gëzim Topçiu:**Sekretari i Këshillit është përgjegjës për ndjekjen e procesit nga A-ZH për të marrë propozimet nga palët.Grupet e Këshilltareve të kenë më shumë se 2 anëtareë në përbërje.Fshati e zgjedh vetë Kryetarin, nëse Këshilltarët nuk shkojnë në fshat procesi duhet të vazhdojë.

**Kryetari i Bashkisë: z.Gëzim Topçiu:**Para 4 vjetësh është ndjekur kjo procedurë, po ju lexoj (dokumenti bashkangjitur).

**Ornildi Demollari:**Unë gjykoj të ndjekim këtë parktikë votimi dhe ndarje fsahtash si në vitin 2019, kërkoj mirkuptimin tuaj të ndjekim këtë praktikë.

**Aleksandra Spaho:**Të vendosen afate për rregjistrimin e kandidatave sidomos për datat 9-10 shtator.

**Ornildi Demollari:**Seketrari i Këshillit do i vendosë këto afate për aplikimet si për gruper politike dhe individët.

**Kryetari i Bashkisë: z.Gëzim Topçiu:**Sot përcaktoni datat dhe ndarjet, pastaj paritë politike, subjektet të sjellin propzoimet.Të gjithë e ndjekin mbledhjen dhe intersohen.

**Aleksandra Spaho:**Të vendosen limite për aplikimet.

**Ornildi Demollari:**Është shumë shumë e rëndësishme të kemi data se e kanalizojnë më mirë punën.

**Yllson Ibrahimllari:**Nuk mund të pengojmë dhe dikë që kërkon të kandidojë ditë e mbledhjes së pleqësisë.

**Kryetari i Bashkisë: z.Gëzim Topçiu:**Vendimi i ka kaluar e ka shprehur qartë, ne përagtisim fletët e votimit me propozimet që kanë ardhur nga dy grupet dhe çdo person që vjen i pavarur të shtohet në fletëne votimit dhe nuk ndodhin keçkuptime.Mendoj lerni të hapur si procedurë dhe çdo grup çon propozimet te Gerti për efekt të përgatitjes së fleteve të votimit dhe fillon procesi, kur ka të pavarur shtohet në fletën e votimit.

**Ornildi Demollari:**Ftoj grupimet politike të punojnë me emrat për kandtiatët për Kryetar të fshatrave, të ndjekim procedurën e para 4 vjetve dhe si metodë pune. Jemi dakord?

Kush është dakord ?

Kundra? Nuk ka.

Abstenim? Nuk ka.

**Ornildi Demollari:**Miratohet me 20 vota pro. Faleminderit! Kalojmë te pika 8 e rendit të ditës, Informacion i kërkuar nga grupi i Këshilltarve Opozitarë në mbledhjen e datës 21.07.2023.Është një informacion lidhur me strukturën tonë për Ujtije-Kullimit.Ka rshur një material që jeni njohur.Nëse keni ndonjë pyetje, kemi Përgjegjsin e Sektorit Ujtije Kullim ose Kryetari.

**Kryetari i Bashkisë: z.Gëzim Topçiu:** Sektori i Ujtije Kullim është një nga Sektorët tanë më rezultativë dhe çdo fermer e di që nuk përmbytet më fusha e Maliqi, kjo efekt për punës tonë.A



ka problematika patjetër që ka, me ujijtjen etj. Nuk kemi basen ujore të mjaftushme me gjithë atë fushë që kemi. Nga ana tjetër, realizimi i disa veprave të rëndësishme, si Stacioni i Pompimit në Lozhan i cili ka rritur ujijtjen dhe këtë vit ka dhënë rezultate shumë të mira, në të njëjetën kohë po bëjmë dhe një Hidrovor në Vreshatas kur ka sasi uji të tepërt ta çojmë te rezervuari i Podgories dhe sot po realizojmë një investim për ushqyesin e rezervuarit të Podgories nga Vërçuni i cili do betonohet dhe pastrohet dhe do të ndryshohen të gjithë Sifonet e ndërtuara, pasi ke qenë deficietare me furnizimin me ujë, për shak të dëmeve dhe amortizimit që kanë pësuar, dimri që vjen do kemi ujë më shumë në rezervuarin e Podgories. Më vjen mirë që anëtarë të Këshillit kërkojnë informacion për strukturat tona dhe kështu bëhen shkas dhe për përmirësimin e punës tonë. Faleminderit!

**Almir Elezi:** Në fshatin Podgorie nuk pati furnizim me ujë nga Strukturat e Bashkisë, por kjo u bë e mundur falë rreshejve të shiut, rezervuari u la të dredheshe në HEC dhe e dyta dëmi që ju shaktua fermerëve ishte shumë i madh.

**Kryetari i Bashkisë: z. Gëzim Topçiu:** Nuk e di te cili HEC ka shkuar uji!? Asnjë liter ujë nuk shkon në HEC dhe nëse ju ja vini zjarrin tokave në fushë, nuk kanë çfarë të bëjnë mjetet e bashkisë. Ne mbajmë përgjegjësi për pastrimin e kanalve kulluese, ku do ku ka patur kërkesë nga fermerët mjetet tona kanë qenë në dispozicion. Hidrovori vendoset në punë kur ka përmbytje në fushën e Maliqit, ujin e tepërt që del nga tokat e përmbytura Hidrovori e çon në rezervuarin e Podgories.

**Fevri Sherifi:** Nj. A Pojan e vleron shumë punën e bashkisë, nuk ka mbetur tokë pa u vaditur në NJ. A Pojan dhe Përgjegjësi i Ujtije-Kullim ka qenë gjithmonë në dispozicion.

**Andonaq Risto:** Kur kemi fjalën për vadtijen dhe jemi atje, një vepër e madhe e sitemit të vadtijes në fushën e Maliqit është dhe kanali i Vendtrokut i cili është lënë harsë, ashtu si tha z. Fevri që vaditen të gjitha tokat në NJ. A Pojan, kjo është e gabuar, se ka shumë Ha tokë që nuk vaditen, pjesa më e madhe vaditeshin në Vendroku. Vendroku është një kanal shumë i madh që përfshin tre bashki të Qarkut Korçë, Devoll, Maliq, Korçë. Duhet parë të futet në punë bashkë me sitemin e Pompimit në Zëmbalk, ky është më i madh në Qarkun e Korçës. Faleminderit!

**Kryetari i Bashkisë: z. Gëzim Topçiu:** Ky kanal ka qenë baze furnizimit me ujë të fushës të Korçës para viteve 90, por furnizimi me ujë nga Liqeni ka rënë dhe ne duhet të gjejmë alterenavtiva të reja për furnizim me ujë ne nuk kemi terricë në Zëmbalak që ta çojmë në Vendtrokut.

**Yllson Ibrahimllari:** Kërkesa është bërë nga grupi i Këshilltarve opozitarë, ka një informacion nga strukturave të bashkisë për kërkesat tona konkrete, ligjiërisht është e bazuar në ligjin 139/2015 dhe Rregulloren e Këshillit bashkiak, drejuesi që ka paraqitur materialin të shohim nëse ju ka dhënë përgjigje pyetjeve të drejtuara në material, materiali është i cektët, ne kemi vënë dhe emra konkret kush do sillte informacion.

**Kryetari i Bashkisë: z. Gëzim Topçiu:** Këshilltarët kanë bërë disa pyetje duke u nisur nga indicje për problematika dhe Sektori përaktës bën një analizë se ku duhet të përgjigjet. Ju jepni një mendim se si është bërë puna në fushë dhe qyetarët na gjykojnë pastaj.

**Petrit Kupe:** Këtu nuk po kërkohet analiza e Sektorit të Ujtije-Kullim, le të na thonë se çfarë kërkojnë, Sektorit të Ujtije-Kullim ka dhënë një informacion të detajaur për punën e kryer.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**Yllson Ibrahimllari:** Kemi dorzuar materialin në bazë të ligjit dhe me pyetje konkrete, materiali e thotë se çfarë problemi kemi, në mbledhjen e datës 10.07.2023 kemi miratuar një vendim për situatën e krijuar në fshatrat Plasë-Zëmbalak nga për mbytyet.

**Kryetari i Bashkisë: z.Gëzim Topçiu:** Nuk ka lidhje Sektori i Ujitje-Kullim me këtë problem. Këshilli i Bashkisë ka marrëdhënie vetëm me Kryetarin e Bashkisë. Nëse kërkoni sa lekë janë shpenzuar ja u ve në dispozicion kur të dëshironi.

**Yllson Ibrahimllari:** Të më japë Sektori i Ujitje-Kullimit, projektin e rezervuarit të Këmbëthekrit nëse shpërthehet Diga.

**Kryetari i Bashkisë: z.Gëzim Topçiu:** Nuk është kompetencë e tij.

**Yllson Ibrahimllari:** Kjo bëhet në kuadër të ligjit për rezevaurët.

**Kryetari i Bashkisë: z.Gëzim Topçiu:** Kryetari i Këshillit, ne japim informacion për atë që na lejon ligji. Faleminderit! Strukturat e bashkisë mos japin asnjë informacion jashtë ligjit.

**Ornildi Demollari:** Kalojmë te pika tjetër e rendit të ditës, Ndryshimet klimatike, ndërmarrja e masave efektive ndaj tyre. Ftoj përgjegjës të Sektorit të Pyje Kullota ta prezantojë materialin.

**Përgjegjës i Sektorit Pyje-Kullota: z.Klarsen Brako:** Po ju prezantoj një material përgatitur me në bashkëpunim me projektin Bashki të Forta. ( material i bashkëpunuar Power Ponit). Faleminderit!

**Ornildi Demollari:** Është një material i përgatitur nga bashkia për ndryshimet klimatike dhe masat që merr. Faleminderit! Ka pyetje?

**Yllson Ibrahimllari:** Në kuadrin e ngrojes globale, ndryshimet klimatike, ka ndonjë ndryshim të zërit kadastral të tokës bujqësore, atje ku kemi juriksionin, pa vendim Këshilli? Të përgëzoj për materialin dhe BF, kemi ne si Bashki djeni për dëmet ekologjike në malin e Lenines? Ku firmat ndërtuese të HEC-ve kalojnë tubin poshtë liqenve dhe thajnë ujin, nuk e kanë këtë licensë për të tërhequr ujin. Kam filuar një iniciativë dhe me dy Bashki të tjera, jam kam dërguar propozimin Bashkisë së Gramshit dhe Pogradecit, për të marrë Lenien, nga Shën Mërena deri te pjesa e Zerecit, me studim të bërë nga një Fondacion Suedez.

**Ornildi Demollari:** Ju po akuzoni se dikush ka shkëlur ligjin dhe dikush po merr ujin e liqenit, denoncoje.

**Yllson Ibrahimllari:** Nuk e denocoj sepse ju si Bashki e keni promovuar si investim mte faqja e Bashkisë.

**Përgjegjës i Sektorit Pyje-Kullota: z.Klarsen Brako:** Ky Liqen është zonë e mbrojtur, ky territor i përket zonave të mbrojtura. Administrohet nga zonat e mbrojtura.

**Yllson Ibrahimllari:** Nuk është e vërtetë. Ma sill dokumentin.

**Kryetari i Bashkisë: z.Gëzim Topçiu:** Dua të shpjegoj dy momente, e para falenderoj doktorin po të marrë nisma që na shërbejnë dhe ne për promovim të zonave tona, për monetin që u fol më lart që ka të bëjë kategoritë e tokës, bashki nuk ka kompetencë për të ndryshuar zërat kadastralë në asnjë rast, tokën bujqësore ta kthejmë në truall, nuk e ka këtë të drejtë Këshilli, Këshilli mund ta ketë dhënë vendimin në parim, por nuk e ka këtë të drejtë për ndryshimin e kategorisë, e dyta bashki Maliq nuk ka dhënë leje për asnjë HEC për gjatë gjithë periudhës, kanë qenë të shtatë Komunave dhe KKRT.

**Yllson Ibrahimllari:** Sektori i Pyjeve në bashki ja dyfishon sipërfaqen me qira nga 0.6 që i kishte dhënë z.Arsen Selimi në 12 ha të kullotave, kjo është maskër urbane.





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**Kryetari i Bashkisë: z.Gëzim Topçiu:**Këshilli ka të drejtë të informohet por jo të drejtojë pyetje pa fund, në çdo rast Këshilli ti kërkojë me shkrim informacionin që kërkon Kryetarit të Bashkisë, Kryetari i Bashkisë e mban dhe vendos kush është struktura që do kthejë përgjigje.Këshilli ka marrë një vendim për si detyrim ligjor për dëmet e shkatuara dhe për atë që ne kërkojmë të marrim nga AKMC për dëmet që shkatuan në ato dy fshatra, ka shkuar dokumentacioni te Prefekti i Qarkut sipas i ligjit, Prefekti i Qarkut ja dërguar AKMC-së. Ata na i kanë kthyer përsëri për efekt të të asaj të ne kishim kërkuar dhe më shumë se duhet, e kemi ripunuar dhe jemi në pritje të një fondi, e kam për komunitetin e Plasës dhe Zëmbalkut, cili do na shërbëjë për veprat e dëmtuara si Prita, Kanale etj.

**Aleksandra Spaho:**Kam diçka lidhur me qentë e rrugës, bashki ka në plan të marrë ndonjë masë?

**Kryetari i Bashkisë: z.Gëzim Topçiu:**Ky është një shqetësim shumë i drejtë, ndoshta me OJF të ndryshme të marrim një nismë për grumbullimin dhe trajtimin e tyre.Shumë shpjet do sjellim një nismë.Faleminderit!

**Ornildi Demollari:**Ka ndonjë sheqetësim tjetër? Kalojmë te diskutime të tjera.

**Idlir Limllari:**Në lidhje me shqetësimin që ngriti doktori, për marrjen e ujit nga liqeni të bëhet një verifikim nga Inspektoriati i Pyjeve.

**Yllson Ibrahimllari:**Të na tregohet harta ku fillojnë dhe mbarojnë zonat e mbrojtura.

**Kryetari i Bashkisë: z.Gëzim Topçiu:**Nëse ka një pretendim duhet të verifikohet, ajo që më shqetëson mua është ajo që a merret ujë atje dhe a lejohet, zyra përaktëse të sjellë hartat përaktse, ne kemi të drejtë të thrasim dhe përfaqësues të zonave të mbrojtura, kemi shqetësim si Këshill ose si Bashki, na jepni një sqarim, si qëndron situata , ajo është pasuri që i tako ntë gjithve dhe nuk duhet shkatruar.

**Yllson Ibrahimllari:**Të gjitha HEC-et janë miratuar kur Kryetari ka qenë Kryetari i Bashkisë të vogël, janë miratuar nga ish Kryetarët e Komunave.

**Ornildi Demollari:**Përgjegjësi i Sektorit të Pyje-Kullota do na sjellë hartën se kujt i takon zonave të mbrojtura apo bashkisë Maliq.

**Përgjegjës i Sektorit: Ujtje-Kullim Astrit Zholi:**Përsëritet! Si anëtar i Këshillit të Basenit të Fierit, kemi autoritetin tja kërkojmë në mënyrë institucionale, pas kërkesës tonë ata vijnë dhe bëjnë vefikim urgjent.

**Yllson Ibrahimllari:**E keni ju komentencë për ta inspektuar në terren.

**Përgjegjës i Sektorit: Ujtje-Kullim Astrit Zholi:**Ne kemi të drejtën të thërasim përfaqësues të Basenit të Fierit dhe ata mund të bëjnë bllokimin e subjektit, e kemi këtë të drejtë.

**Kryetari i Bashkisë: z.Gëzim Topçiu:**Do kërkoja Këshillit që për çdo çështje të kërkojë informacion te Kryetari i bashkisë.

**Ornildi Demollari:**Kemi dhe një kërkesë derjtuar Këshillit, por është për bashkinë.Kërkesë bërë nga z.Andonaq Risto kryetar fshati Tërov.(bashkangjitur kërkesa)

**Kryetari i Bashkisë: z.Gëzim Topçiu:**Kërkesa është shumë e rëndësishme dhe nuk është vetëm për këtë zonë, kjo ndodh në shumicën e fshatrave të bashkisë, ajo çka unë mendoj kërksa ti kalojë DPKTT për të parë disa lehtësira për efekt të ngrijes së strukturave provizore.Por problem për këtë mund të jetë toka, të kërkojmë një inforamcion nga kjo drejtori, ndoshta Këshilli dhe Bashkia gjejnë një klauzolë ta displonojë këtë.





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**Server Xhuti:**Kemi marrë vendim më parë që stallet të jenë jashtë fshatit.

**Petrit Kupe:**Ka ndryshuar baza ligjore për dhënien e lejave për objektet blekorale, duhet parë nga Urabnistika.

**Idlir Limllari:**Kjo zgjidhet me deklaratë para prake por duhet të ketë truallin e tij.

**Fevri Sherfi:**Fermerët kanë probleme dhe dëmet që ju bëhet në të mbjella nga bagëtitë.

**Ornildi Demollari:**Grupi i Këshilltrave të opozotës ka një material për të lexuar.

**Eglantina Balli:**Po ju lexoj kërkesën në emër të grupit (materiali bashkangjitur)

**Ornildi Demollari:**Falemiderit!

**Kryetari i Bashkisë: z.Gëzim Topçiu:**Nuk i heq asnjë presje, materiali ishte korrekt, ti kalojë Sektorit të Shërbimit Social, në mbledhjen e radhës të sjellin asnjë informacion.Do sygjeroj që Sektori përkatës të sjellë ndihmë konkrete për rastin në fjalë.Kemi dhe një Qendër Komunitare financuar nga PNUD për raste të kësaj natyre.

**Ornildi Demollari:**Ka dhe diçka të fundit.

**Specialiste e Sektorit të Shërbimit Social: Agathi Ngjela:**Kemi një rast emergjent për ndihmë financiare në qyetetin e Maliqit, ka të bëjë me një ndërhyrje kirurgjikale të vështirë dhe tani kërkon ekzaminime të tjera që kushtojnë, i propozojmë Këshillit që familja Agastra të trajtohet me 50.000 lekë.

**Kryetari i Bashkisë: z.Gëzim Topçiu:**Këshilli ta miratojë në parim dhe më pas të bëhet rrakordimi me financën për fondet.

**Ornildi Demollari:**E kalojmë në votim?

Kush është dakord ?

Kundra? Nuk ka.

Abstenim? Nuk ka.

**Ornildi Demollari:**Miratohet me 19 vota pro. Këshilltari Yllson Ibrahimllari u largua nga salla.Faleminderit!i urojmë shërim të shpjjetë. Kjo ishte mbledhja.

**Mbajtës Protokolli**

**SEKRETARI I KËSHILLIT**

**Gertjan GJIRITI**

**KRYETARI I KËSHILLIT**

**Ornildi DEMOLLARI**